

Rektori i Universitetit të Arteve Prof. Petrit Malaj mbajti fjalimin përshëndetës ku një vend të veçantë zuri përshëndetja e drejtuesve të institucionit dhe pedagogëve dhe studentëve ndër vite: -“...Është tamam rasti të përmend drejtuesit e kësaj shkolle që nga fillimet e saj, profesoret e nderuar Albert Paparisto, Vilson Kilica, Tefik Çausi, Lili Zhamo, Ibrahim Madhi, Kristo Jorgji, Jakup Mato, Fatmir Hysi, Bujar Kapexhiu, Gjergj Zheji e Kastriot Çausi, për të cilët dëshiroj të shpreh këtu, besoj edhe në emrin e të gjithëve ju, respektin më të thellë, për punën dhe përpjekjet e bëra ndër vite...”

“...Kontributi i brezave të tërë të pedagogëve dhe studentëve ka bërë që jeta artistike të jetë ndikuar fuqishëm dhe pozitivisht prej krijimtarisë dhe interpretimit të tyre....”- vazhdon më tej Prof. Malaj, -“...Projektet e shumta krijuese e artistike të realizuara nga studentët e pedagogët e Universitetit të Arteve vitet e fundit përfshijnë një gamë të gjerë të gjinive të artit në të gjitha fushat, si në muzikë, dramë, arte pamore dhe aplikative ashtu dhe interdisiplinore si:

- Opera e të rinjëve, Koncerte vokalo-simfonike, koncerte të Muzikës së Dhomës, Festivale të krijuesve të rinj, koncerte Recitale
- Vënie në skenë të dramave, komedive, veprave koreografike apo mbrëmjeve poetike
- Ekspozita pikturë dhe skulpturë
- Promovime figurash të shquara të artit kombëtar shqiptar, tryeza të rrumbullakta, botime katalogësh;
- Master-class-e, projekte interdisiplinore dhe realizime eksperimentale,etj.

Këto projekte realizohen në sallat, galeritë dhe mjediset e Universitetit të Arteve duke gjallëruar më shumë edhe jetën kulturore-artistike të kryeqytetit si dhe duke rritur në këtë mënyrë konkurrencën në tregun artistik....”

Shndërrimi i Akademisë në Universitet ishte një tjetër moment i rëndësishëm në fjalën e rektorit ku sigurisht një falenderim tëi veçantë ju bë Kryeministrit dhe Ministrit të Arsimit për bashkëpunimin dhe mbështetjen: - “...Me fillimin e vitit akademik 2011 – 2012 shkolla jonë është shndërruar nga “Akademi e Arteve” në “Universiteti i Arteve”. Ngritja në Universitet përkon me këtë përvjetor të rëndësishëm dhe personalisht ndihem krenar që së bashku me kolegët pedagogë dhe të gjithë bashkëpunëtorët dhe sigurisht me ndihmën e studentëve, arritëm që shkollën tonë ta ngremë në një nivel më të lartë institucional, duke synuar në rritjen e standardeve të ofertave tona akademike.

Do të dëshiroja të ndalesha në bashkëpunimin institucional që Universiteti i Arteve ka arritur të vendosë kryesisht me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, dhe me qeverinë shqiptare, me

synimin për të arritur objektiva të përbashkëta madhore që lidhen ngushtësisht me specifikat e shkollës sonë të artit.

Një vlerësim të veçantë do të doja të shprehja për bashkëpunimin që kemi vendosur me qeverinë, duke e falënderuar z. Kryeministër, të cilin kemi nderin ta kemi mes nesh sot, në këtë ditë festive, për mbështetjen personale që ai i ka dhënë shkollës sonë. Gatishmëria e tij për të miratuar krijimin e Universitetit të Arteve, na ka gëzuar të gjithëve ne pedagogë e studentë. Po ashtu nuk mund të lë pa përmendur mbështetjen e madhe që Kryeministri i ka dhënë idesë sonë për realizimin e Qytetit të Arteve, një projekt i ideuar dhe realizuar me synimin nga njëra anë për të nxitur jetën kulturore e artistike të kryeqytetit dhe nga ana tjetër për të krijuar mundësi dhe alternativa për studentët e pedagogët e Universitetit të Arteve, për të shprehur me zë të plotë punën, talentin dhe profesionalizmin e tyre në sytë e publikut të gjerë artdashës...”

Në këtë fjalë përshëndetëse Prof. Malaj vuri theksin gjithashtu dhe në ecurinë akademike si të trupës së pedagogëve ashtu dhe të studentëve gjithashtu dhe në vendosjen e lidhjeve bashkëpunuese me institucione të tjera të artit: - “...Përparimi akademik i trupës së pedagogëve ka qenë dhe vazhdon të jetë në qendër të vëmendjes sonë. Ne kemi sot të përfshirë në procesin mësimdhënës 41 Profesorë, 54 Profesorë të Asociuar, 13 Docente, dhe 284 Lektorë, të cilët sigurojnë cilësinë dhe standardet akademike që kërkohet për institucionet e arsimit të lartë publik. Këshillat e Profesorëve në Universitetin e Arteve, ditë pas dite, janë në punë për të shqyrtuar dosjet dhe kërkesat e pedagogëve për marrjen e titujve të ndryshëm akademik. Prioritet i yni është gjithashtu edhe tërheqja dhe përfshirja në procesin didaktik të individëve me cilësi të spikatura jo vetëm në fushat e artit, por edhe në aspektin akademik, duke tentuar të krijojmë bazën për ruajtjen e zhvillimin e standardeve të arritura, për të ardhmen Aktualisht në auditorët e UART studiojnë 940 studentë, të cilët përfaqësojnë më të rinjtë nga ajo mori brezash që kanë kaluar në klasat, auditorët, skenat dhe ekspozitat e kësaj shkolle. Mbi 5000 studentët e diplomuar në Institutin e Lartë të Arteve dhe Akademinë e Arteve, kanë qenë motori i artit tonë dhe vazhdojnë të jenë sot bartësit kryesor të traditave më të vyera artistike e kulturore shqiptare...”

“...Bashkëpunimi me organizma si brenda dhe jashtë vendit mbetet për Universitetin e Arteve një nga shtyllat e zhvillimit strategjik....

...Forcimi i lidhjeve institucionale me Organizma Ndërkombëtare të Artit, me Akademi dhe Universitete të Artit në Evropë, si edhe rritja e bashkëpunimit me institucionet homologe në hapësirën mbarëshqiptare, janë prioritet i stadi aktual të Universitetit të Arteve...”